



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
KRYETARI

Nr. 671 .Prot.

Berat, më 03/02/2020

V E N D I M

Nr. 64 datë 03/02/2020

PËR

PLANIN VJETOR TË PRANIMIT TË ADMINISTRATËS SË BASHKISË BERAT
PJESË E SHËRBIMIT CIVIL PËR VITIN 2020

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”, neni 8 ,pika 2, neni 9 ,gërma b, të nenit 18 të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin Civil”, I ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr 108 , datë 26.02.2014”Për planin vjetor të pranimit në Shërbimin Civil”, Vendimin e Kryetarit të Bashkisë Berat nr.925 Prot, datë 26.11.2018 “Miratimi i strukturës së Bashkisë Berat” , i ndryshuar”, informacionit të Njesisë Përgjegjëse të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të datës 06.01.2020 “Për pozicionet e lira të krijuara per vitin 2020”, Kryetari i Bashkisë ,

V E N D O S I:

1.Numri i vendeve vakante të planifikuara për rekrutim , në administratën e Bashkisë Berat, pjesë e shërbimit civil për vitin 2020 është gjithsej 9(nëntë), sipas kategorive të mëposhtëme:

a)Për kategorinë ekzekutive 7(shtatë).

2.Grupet e administrimit të përgjithshëm dhe të posaçem në kategorinë ekzekutive janë si më poshtë :

- Shkenca Juridike
- Inxhinierisë së ndërtimit
- Shkenca Ekonomike
- Shkenca shoqërore
- Shkenca Sociale

3.Drejtoritë ku planifikohen vendet vakante janë :

- Drejtoria e Planifikimit dhe zhvillimit të Territorit
- Drejtoria e të Ardhurave
- Drejtoria e Financës
- Drejtoria e Energjencave Civile, Shërbimeve dhe Pronave
- Drejtoria e Zhvillimit Strategjik dhe Integrimin European .
- Drejtoria e Prokurimeve Publike
- Drejtoria e Shërbimit Social



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
KRYETARI

b)Për kategorinë e Mesme Drejtuese 1(një)pozicion

4.Drejtoria ku planifikohet të shtohen vendi vakant është :

- Drejtoria e të Ardhurave

c)Për kategorinë e lartë drejtuese 1(një)pozicion

- Sekretar I Përgjithshëm

5.Ngarkohet Drejtoria e Burimeve Njerëzore ,Marrdhënieve me Publikun dhe Juridike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, për zbatimin e këtij vendimi.

6.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BASHKISË

Ervin Demo





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE, MARRDHËNIEVE ME PUBLIKUN
DHE JURIDIKE

Nr. 0711.Prot.

Berat, më 03/02/2020

Lënda : Kërkesë për publikim plani vjetor të pranimit në shërbimin civil

Drejtuar : SHËRBIMIT KOMBËTAR TË PUNËSIMIT ,TIRANË

Në zbatim të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar ,neni 18 si dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.108 datë 26.02.2014 “Për planin Vjetor të Pranimit në Shërbimin Civil”, bashkëlidhur po ju dërgojmë për publikim planin vjetor të Pranimit në Shërbimin Civil të Bashkisë Berat për vitin 2020 .

Faleminderit për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin.

KRYETARI I BASHKISË

Ervin Demo

